

## **RELACION TEKNIK PLOTËSUES**

### **PUNIME INFRASTRUKTURE PËR BANESAT INDIVIDUALE**

Pas tërmetit të datës.26.11.2019, Qeveria Shqiptare është angazhuar për rindërtimin e komplekseve të objekteve të banimit, si dhe për rindërtimin e banesave individuale të dëmtuara në zonat administrative të bashkive: Durrës, Shijak, Kavajë, Vorë dhe Krujë (Kavajë). Mbas vizitës në terren në disa nga objektet e parashikuara për t'u rindërtuar në këto zona është bërë vlerësimi i disa punimeve shtesë për ndërtimin e infrastrukturës në këto objekte. Zërat e punimeve për infrastrukturën nuk përfshihen në preventivat bazë të banesave individuale, por ato janë vlerësuar si të domosdoshme për të bërë funksionale këto banesa. Për këto arsye punimet shtesë për infrastrukturën janë konsideruar kryesisht punime për prishjen e objekteve ekzistuese, përgatitjen e sheshit të ndërtimit, punimet për ndërtimin e infrastrukturës dhe lidhjen me rrjetet inxhinierike ekzistuese të banesave të reja që do të ndërtohen. Punimet për Infrastrukturën për shtëpitë individuale përshkruhen si më poshte:

#### **I. PUNIME PËR AKSES NË KANTIERIN E NDËRTIMIT**

Për këtë proces parashikohet ndërtimi i një rruge provizore për hyrjen e mjeteve dhe makinerive të ndërtimit (Kamion veteshkarkues, betonier, autopompe, autovinc etj), në kantier. Rruga duhet të garantoj stabilitet dhe kushte optimale operimi, pavarësisht kushteve atmosferike dhe atyre të terrenit të zonës së rindërtimit. Punimet kryesore për ndërtimin e kësaj rruge janë:

1. Gërmim dheu me ekskavator me goma për hapje të trasesë së rrugës dhe;
2. Mbushje me çakull e gur gurore, të përhapur e ngjeshur me makineri në trupin e hapur të rrugës hyrëse të kantierit të ndërtimit
3. Transporti i materjaleve të nxjerra nga hapja e aksit rrugor me automjete deri në 4 km, në një territor të përcaktuar më parë nga bashkia.

Ky segment rrugor me gjerësinë e sipërpërmendur, do të shërbej edhe si mënyrë aksesimi për banorët pas ndërtimit të banesës individuale. Për këtë arsye aksi rrugor në përfundim të punimeve dhe dorëzimit të banesës së rindërtuar duhet të jetë në kushte optimale, për tu përdorur nga banorët e zonës, sipas përcaktimeve të pikës V (Punime Sistemimi të Jashtme).

#### **II. PUNIME PRISHJE, GËRMIMI DHE PREGATITJE SHESHI NDËRTIMI.**

Pas rrethimit të sheshit të ndërtimit, të gjitha banesat/ shtëpitë pavarësisht shkallës së dukshme të dëmtimit duhet të prishen totalisht, e më pas të bëhet evadimi i materialeve nga sheshi i ndërtimit. Për këtë proces parashikohet mbajtja e një reacioni shpjegues në prezencë të supervizorit, ku duhet të shtjellohet koha, mjetet, mënyra dhe procesi i prishjes të të gjithë elementëve përbërës të godinës dhe të infrastrukturave të saj, të parashikuara nga konkluzionet e analizës së thelluar ndaj tërmetit si DS4/ DS5.



1. Elementet përbërës të prishjeve janë; çatia, soletat beton arme, kolonat konstoktive (betonarme), muraturat e jashtme dhe të brendshme (të tullës, blloqeve të betonit, apo materjaleve të tjera), verandat dhe konsolat e elementet veshëse të dekorit arkitektonik, dyshemesë së betonit, themeleve dhe mbushjeve me materiale të ndryshme të bazamentit të banesës, gropave septike dhe rrjeteve të amortizuar të kanalizimeve të këtyre të fundit. Komponentët të cilët sipas supervizorit nuk janë të përshtatshëm për ripërdorim, duhen larguar, punë kjo që kryhet nga kontraktuesi me automjet në një vend-depozitimi të caktuar nga bashkia përkatëse, deri në një distancë prej 4 km. Materialet që janë të ripërdorshme do të mbeten në pronësi të investitorit dhe do të ruhen në vende të veçanta nga kontraktori, derisa të lëvizin prej tij deri në përfundim të kontratës.
2. Gjatë kryerjes të punimeve prishëse, kontraktuesi duhet të marrë masa që të mbrojnë godinat, gardhet, muret rrethues dhe strukturat që gjenden në afërsi të objektit, ku po kryhen këto punime prishëse, duke garantuar se ka marrë masa mbrojtëse para fillimit të ndërhyrjes. Për këtë duhen evituar mbingarkesat nga të gjitha anët e strukturave nga grumbuj dhe materiale të cilat mund të krijojnë tensione të jashtme. Kur grumbujt dhe materialet duhen zbritur poshtë, duhet pasur kujdes që të parandalohet shpërndarja ose rënia e materialeve, ose të projektohet në mënyrë të tillë, që mos të përbëjë rrezik për njerëzit, strukturat rrethuese dhe pronat publike apo ato të çdo lloji tjetër.
3. Kur përdoren mekanizmat për prishje si: vinç, ekskavatorë hidraulik dhe thyes shkëmbinjsh të bëhet kujdes, që pjesë të tyre të mos kenë kontakt me kablllo telefonik ose elektrik dhe rrjete të tjera të infrastrukturave lidhëse. Kontraktori duhet të informojë në fillim të punës autoritetet përkatëse, në mënyrë që ato të marrin masa për lëvizjen e kablllove.
4. Kontraktori duhet të ngrejë rrjete të përshtatshme, barriera mbrojtëse, në mënyrë që, të parandalojë aksidentime të personave ose dëmtime të godinave rrethuese nga materialët që bien, si dhe të mbajë nën kontroll territorin, ku do të kryhen punimet.
5. Në lidhje me përgatitjen e sheshit të ndërtimit janë parashikuar punimet për gërmimin dhe nivelimin e sheshit të ndërtimit bazuar në kushtet konkrete të terrenit brenda zonës së rrethimit të kantierit. Në vartësi të volumit dhe tipologjisë të materialit të dalë nga gërmimi mund të vendoset nga supervizori edhe mundësia e depozitimit të një pjese të inerteve pranë sheshit të rindërtimit të banesës, për tu përdorur më pas si material për sistemime të terrenit mbas ndërtimit ose duhet të vendoset me relacion vend-depozitimi ku duhet të evadohen nga sheshi i ndërtimit.
6. Ky proces do të përfshijë heqjen nga kantieri i punës të gjithë bimesisë, shkurreve dhe mbeturinave nën dhe në sipërfaqe të territorit të ndërtimit me udhëzimin e mbikqyresit të punimeve. Pastrimi i bimësisë dhe dherave të tepërta do të kufizohet në përgjithësi tek një maksimum dimensiononi të barabartë me shtrirjen e propozuar të punimeve, të parashikuar në preventiv. Përtej këtij përcaktimi, bimësia e lartë ekzistuese mbi 1 metër, që nuk pengon ndërtimin e banesës së re do të rrijë e paprekur. Në përgjithësi duhet patur parasysh, që gjatë punimeve të pastrimit të mos dëmtohen ato pemë të cilat nuk pengojnë në rehabilitimin ose në ndërtimin e objektit të ri. Në rastet kur heqja e tyre është e domosdoshme, duhet të merren masa mbrojtëse



## FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT ALBANIAN DEVELOPMENT FUND

në mënyrë që gjatë rrëzimit të tyre të mos dëmtohen personat dhe objektet përreth. Për këtë arsye, për pemët që janë të larta mbi 8 m, duhet që prerja e tyre të bëhet me pjesë nga 3 metra me mjete sigurie. Pjesa që pritet, duhet të lidhet me litar ose kavo dhe të tërhiqet nga ana ku sigurohet mbrojtja e personelit dhe e objekteve.

### III. PUNIME PËR LIDHJEN ME RRJETET INXHINIERIKE KUB DHE FURNIZIM ME UJË

Për këtë proces do përfshihen të gjitha punimet e nevojshme për ndërtimin dhe lidhjen e rrjetit KUB, si dhe lidhjen e godinës me rrjetin e ujësjellësit. Në varësi të kushteve të rrjeteve ekzistuese dhe sipërfaqeve të truallit parashikohet:

1. Ndërtimi i rrjetit të infrastrukturave KUB që përfshin; Gërmim kanal dheu me eskavator 0.25 m<sup>3</sup>, me gjerësi deri në 2 metra, heqje dhe transport dherash në një zonë të përcaktuar nga bashkia, F.V tuba të brinjëzuar HDPE SN8 d=250 mm dhe ndërtimi i rrjetit të pusetave e pikave të kontrollit me puseta b/a shiu 40 x 40 cm, h = 100 cm, me kapak zgare hekuri për mbrojtje e rrjetit të tubacioneve dhe mbushje kanalesh me dhe deri në kuotën e bazës së sistemimeve, lidhje me pikën e shkarkimit nga banesa. Në rast se nuk ka rrjete ekzistuese KUB atëherë është parashikuar largimi i ujit të shiut nga banesa nëpërmjet një kanali natyral ose të shtruar me beton me gjatësi mesatarisht deri në 25 ml.
2. Ndërtimi i linjës së furnizimit të ujësjellësit nga pika e furnizimit deri te banesa që përfshin, hapje kanalesh dhe F.V Tuba e rakorderi ujësjellësi PE d=32mm, t = 3.6 mm, PN 20 dhe aksesoret përkatës shoqëruar, puse kontrolli B/A, 80 x 80 cm, h = 100 cm me kapak gize, dhe lidhje me pikën e furnizimit të banesës.
3. Në rast se nuk ka rrjete ekzistuese KUB atëherë është parashikuar largimi i ujit të shiut nga banesa nëpërmjet një kanali natyral ose betoni me gjatësi mesatarisht 25 ml.

### IV. PUNIME PËR LIDHJEN ME RRJETET INXHINIERIKE KUZ

1. Ndërtimi i KUZ rreth 40 ml, ku përfshihen F.V tub PVC dhe ndërtimi i pusetave të kontrollit. Në rast se mungesës së rrjetit KUZ është parashikuar ndërtimi i një gropë septike në largësi 25 ml nga banesa që do të ndërtohet;
2. Ndërtimi i rrjetit të infrastrukturave KUZ përfshin; Gërmim kanal dheu me eskavator 0.25 m<sup>3</sup>, me gjerësi deri në 2 metra, heqje dhe transport dherash në një zonë të përcaktuar nga bashkia, F.V tuba të brinjëzuar HDPE SN8 d=250 mm dhe ndërtimi i rrjetit të pusetave e pikave të kontrollit me puseta b/a shiu 40 x 40 cm, h = 100 cm, me kapak zgare hekuri për mbrojtje e rrjetit të tubacioneve dhe mbushje kanalesh me dhe deri në kuotën e bazës së sistemimeve, lidhje me pikën e shkarkimit nga banesa.
3. Në rast se nuk ka rrjete ekzistuese KUZ atëherë është parashikuar largimi i ujrave të zeza nga banesa nëpërmjet një kanali nëntokësor që lidhet me një gropë septike betoni 2x2x1,5m në një sistancë mesatarisht 25 ml larg perimetrit të banesës, sipas përshkrimeve të zërave të preventivit. Gropa septike duhet të jetë e mbyllur dhe të garantoj ajrosje sipas përcaktimeve dhe kushteve higjieno – sanitare. Ajo duhet të pozicionohet në mënyrë të tillë që të garantoj mundësinë e pastrimit në të ardhmen



nëpërmjet automjeteve të pastrimit të tipologjisë autobot.

## **V. PUNIME SISTEMIME TË JASHTME**

Në këtë proces përfshihen punimet e gërmimit/ mbulimit dhe vendosja e rrjetit të tubacioneve të kullimit, gërmimit dhe transportimit të dherave të tepërta, mbushjes së shtresave të kantierit të ndërtimit dhe realizimit të mureve rrethuese apo rrethimit perimetral me rrjete metalike të pronësisë së banesës, krijimit të nënshtresave të zhavorrit dhe rrugëve, rampave dhe verandave me shtresa dhe bordura betoni brenda territorit të kantierit, pastrimi sistemimi dhe mbjellja e territorit të gjelbër të oborrit të banesave, shtrimi i bordurave apo pllakave të betonit anësore të lëvizjes rreth objektit të rindërtuar si edhe ndërtimi rrugës hyrëse për në banesë.

Nivelimi i terrenit duhet të bëhet sipas nevojës, formës së tij të paraqitur në projekt dhe mjeteve financiare të vëna në dispozicion për arritjen e këtij qëllimi. Në rast se pas rindërtimit të banesës rezulton se territori ska nevoja për heqje dhe largim dherash, atëherë kontraktori pas mbajtjes së aktkonstatimit me supervizorin, ka të drejtë të operoj në oborrin e gjelbër vetëm me detyrën e dekorimit, në atë formë truall qe ekziston.

Pa marrë parasysh nivelimin e terrenit, kontraktori duhet të përgatisë terrenin në atë mënyrë, që të garantohet mirëmbajtja e pejsazhit edhe pas përfundimit të punimeve, duke garantuar mundësi furnizimi me ujë për vaditje minimalisht në 2 skaje të territorit të gjelbër. Në rast të mungesës së tokës së mirë (pjellore), duhet sjellë humus nga territore të tjera dhe të garantohet shtrimi me një shtresë min. 20 cm ose sipas projektit.

## **VI. PUNIME ELEKTRIKE**

Punimet elektrike duhet të garantojnë ndërtimin e linjës së furnizimit me energji elektrike nga pika e marrjes së TU deri tek banesa.

Në këtë proces pune përfshihet hapja e kanaleve në territor, gërmim dhe mbushje dheu me krah për kanale kategoria e III h=1.5 m.

Vendosja e shtresave mbrojtëse plastike për rrjetin elektrik, F.V me kabëll tre fazor dhe aksesoret përkatës për gjatësinë mesatare deri në 50 m. Kablli i energjisë elektrike duhet të garantoj Cu fuqie -1000 V me izolim gome e mbulese plastmasi, te armuar, 3x10 mm<sup>2</sup>

Instalimi elektrik në përgjithësi duhet të jetë i plotë në të gjitha pikëpamjet (montimi dhe materiale) sikurse është treguar në projekte dhe skica, përshkruar me specifikimet ose udhëzimet e projektuesit. Montimi duhet të përfshijë furnizimin me energji elektrike për të gjitha pajisjet elektrike të cilësuara dhe të ofruara, si edhe pajisjet e ofruara dhe të instaluarat nga të tjerët.

Pika e furnizimit të pajisjeve duhet të jetë kutia terminale furnizuese në pajim ose aparati i afërt mbyllës (izolues)/hapës. Pozicioni i gjithë pikave në skicat e paraqitura të sistemimit është i përafërt dhe duhet konfirmuar nga kontraktuesi duke iu referuar skicave të projektit dhe vendodhjes së pikave të marrjes së TU në territor, duke ju përshtatur dhe zbatuar të gjitha rregullat e ambienteve të hapura. Kontraktuesi duhet të vizitojë (kontrollojë) kantierin para se të vlerësojë qëllimin (fushën, sferën) e punës.

**Përshkrimi i mësipërm i proceseve të punës për ndërtimin e Infrastrukturës në banesat e reja individuale është orientues për tu ardhur në ndihmë operatoreve ekonomik gjatë hartimit të ofertës. Ky përshkrim lidhet edhe me 2 fletë orientuese skematike të projektit të infrastrukturave për:**

- 1. Paraqitje të punimeve për akses në kantier dhe punime prishje-gërmim;**
- 2. Paraqitje të punime të ndërtimit të infrastrukturave dhe sistemimit të jashtëm;**

Përshkrimi i mësipërm i relacionit dhe 2 fletët e projektit janë orjentuese të paraqitura për rastet kur kërkohet ndërhyrja e tipologjisë maksimale si në akses dhe në lidhjen e banesave me pikat e shkarkimit me gropë septike.

Në rastet kur kjo mënyrë lidhje me infrastrukturën nuk është e nevojshme pasi rrjeti KUZ në zonë e mundësoj lidhjen, atëherë mund të vijohet lidhja sipas përcaktimeve të parashikuara në legjislacion, rrjetin KUZ.

Për banesat individuale të cilat ndodhen brenda zonave të rindërtimit me PDYV, operatori do të realizoj lidhjen e infrastrukturës së banesave individuale me rrjetin e parashikuar të infrastrukturës të të gjithë zonës, si edhe aksesin rrugor kundrejt lidhjes së hyrjes së banesës me rrugët e zonës së rindërtimit.